

TERMA REFERENCE

EKSPERT MONITORIMI PËRMBLEDHJEN E TË DHËNAVE DHE FORMULARËVE TË DEKRIMINALIZIMIT PËR KRYETARËT E BASHKIVE DHE ANËTARËT E KËSHILLAVE BASHKIAKË, ME NË FOKUS DIBRËN, KUKËSIN DHE SHKODRËN

Pozicioni / Shërbim	Ekspert monitorimi i jashtëm për mbledhjen e të dhënave dhe formularëve të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën.
Titulli i Projektit	“Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike”
Mbështetur:	Projekti financohet nga Ambasada Britanike në Shqipëri
Lloji i Kontrates :	Kontratë shërbimi – ekspert për mbledhjen e të dhënave
Periudha e kontratës	Janar - Shkurt 2024
Ditët e punës	10 ditë pune

Informacion i përgjithshëm për Projektin

- Projekti ka për qëllim të kontribuojë në parandalimin dhe shfaqjen e ndikimeve të panevojshme përmes angazhimit, monitorimit, ngritjes së kapaciteteve dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmes informimit të një grupi të rëndësishëm të aktorëve dhe palëve të interesuara për të siguruar implementimin e drejtë dhe të lirë nga ndikimet e panevojshme në procesin zgjedhor.
- Instituti i Studimeve Politike synon të monitorojë transparencën dhe llogaridhënien në zbatimin e standardeve të dekriminalizimit dhe integritetit për kandidatët, subjektet

zgjedhore dhe institucionet e përfshira në procesin zgjedhor dhe produktet e tij zgjedhore në periudhën paszgjedhore.

Qëllimi i shërbimit

Në kuadër të implementimit të “*Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike*”, Instituti i Studimeve Politike kërkon një Ekspert monitorimi i jashtëm për mbledhjen e të dhënave dhe formularëve të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën.

Për zbatimin e projektit, eksperti do të jetë përgjegjës për:

- Verifikimin dhe mbledhjen e të dhënave që lidhen me kandidatët për zgjedhjet lokale 2023 ;
- Verifikim, shqyrtim dhe aksesimi formularëve të dekriminalizimit;
- Mbledhjen e të dhënave për zyrtarët e lartë përmes komunikimeve zyrtare me institucionet;
- Të mundësojë dorëzimin e materialit në format Excel;
- Të mundësojë dorëzimin e timesheet-eve, duke raportuar mbi orët e shërbimit të realizuara në përputhje me qëllimin e shërbimit të kërkuar, apo çdo dokument shoqërues që do të duhet për raportimin e shërbimit;
- Të jetë disponibël për të përmbushur detyrimet lidhur me shërbimin e kërkuar sipas afatit kohor të përcaktuar;
- Të mbrojë konfidencialitetin e informacionit dhe të dhënave që do mund të merren gjatë ofrimit të shërbimit.

Profili i ekspertit:

- Diplomuar në nivelin Master Profesional/Shkencor për Shkenca Politike ose Juridike;
- Ekspertizë në metodat sasiore dhe cilësore të kërkimit;
- Eksperienca të mëparshme në monitorim;
- Njohës i legjislacionit zgjedhor;

Aftësitë individuale:

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi në ekip dhe jo vetëm;
3. Të ketë aftësi shumë të mira monitorimi;
4. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura.

Dokumentet e Aplikimit:

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. CV e detajuar
2. Ofertë Financiare e nënshkruar në GBP

Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 1500 GBP (një mijë e pesëqind) bruto. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga eksperti për punën e kryer.

Aplikimi duhet të dërgohen në një nga 3 variantet, jo më vonë se data 23/01/2024 ora 12:00

1. **Në formë elektronike** në adresën e e-mailit contactaips@gmail.com,
2. **Me postë** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike – ekspert monitorimi i jashtëm për mbledhjen e të dhënave dhe formularëve të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr “Luigj Gurakuqi”, Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë
3. **Dorazi** me zarf të mbyllur titulli i projektit sipër “*ISP_Fuqizimi i integritetit të zgjedhjeve dhe i qëndrueshmërisë së partive politike - ekspert monitorimi i jashtëm për mbledhjen e të dhënave dhe formularëve të dekriminalizimit për kryetarët e bashkive dhe anëtarët e Këshillave Bashkiakë, me në fokus Dibrën, Kukësin dhe Shkodrën. Të mos hapet përpara datës së tenderit.*”, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë

(Lutemi specifikoni qartë e-mail ose një nr. kontakti.)

Instituti i Studimeve Politike